

UNIVERSITETI “HAXHI ZEKA” PEJË
FAKULTETI I MENAXHIMIT NË TURIZËM HOTELERI DHE MJEDIS



Punim Diplome

Rëndësia e sistemit të Menaxhimit të cilësisë në industrinë e Hotelerisë

Mentori:

Prof.ass.Dr.Merita Begolli-Dauti

Kandidatja:

Albina Bajraktaraj

Pejë, 2024

UNIVERSITETI “HAXHI ZEKA” PEJË
FAKULTETI I MENAXHIMIT NË TURIZEM DHE HOTELERI
PUNIM BACHELOR

Lënda nga e cila është bërë punimi: Menaxhimi i cilësisë

Tema e punimit: Rëndësia e sistemit të Menaxhimit të cilësisë në industrinë e Hotelerisë

Emri dhe mbiemri i studentit:	Albina Bajraktaraj
Satusi i studentit:	I rregullt
Numri i amzës:	310242020
Drejtimi-Departamenti:	MTHM
Shkalla e studimit:	Bachelor
Mentori:	Prof.ass.Dr.Merita Begolli-Dauti

Abstrakti

Rëndësia e cilësisë në industrinë e hotelerisë përfshin ofrimin e vazhdueshëm të produkteve dhe shërbimeve të mysafirëve sipas standardeve të pritura. Ofrimi i shërbimit cilësor është një nga sfidat kryesore me të cilat do të përballen menaxherët e mikpritjes, pasi është një kusht thelbësor për suksesin në tregjet të mikëpritjes në zhvillim, pasi që është një treg shumë konkurrues. Ka mjete të ndryshme që mund të përmirësojnë shërbimin cilësor, duke përfshirë edhe mekanizma të ndryshme për njohjen e cilësisë në industrinë e turizmit dhe hotelerisë. Menaxherët duhet të identifikojnë, regjistrojnë dhe peshojnë ndikimet e kosto-fitimit dhe të jenë në gjëndje të paraqesin kreativitete të reja drejt një procesi të përmirësimit të cilësisë për pronën e tyre. Rëndësine e turizmit e perceptojnë shërbimin cilësor në një hotel si vlerë për paratë, një dhomë të rehatshme, staf miqësor, ushqim të mirë dhe se duhet të ketë gjithmonë hapësirë për përmirësim të mëtejshëm të shërbimeve të mikpritjes. Faktorët më të rëndësishëm për të ardhmen e një hoteli janë kënaqësia e mysafirëve, fokusimin në shërbim cilësor, mbajtja e mysafirëve ekzistues duke tejkaluar pritshmëritë e tyre, përmirësim i vazhdueshëm i cilësisë, punësimi trajnimi i rregullt dhe fuqizimi i stafit të orientuar drejt shërbimit, paraqesin rëndësine e menaxhimit të cilësisë në hotelëri.

Fjalët kyçe: menaxhimi i cilesise, industria hoteliere, planifikimi, mikpritja, shërbime etj.

Përmbajtja

Abstrakti.....	3
Kapitulli I	
1.Hyrje.....	6
1.1.Qëllimi i hulumtimit	6
1.2.Kontributi shkencor-praktik i hulumtimit.....	7
1.3.Metodologjia e hulumtimit	7
1.4.Rëndësia e punimit	7
Kapitulli II.....	
2.Funksioni i menaxhimit të cilësisë	8
2.1.Mjetet e planifikimit të menaxhimit të cilësisë	9
2.2.Procesi i ofrimit të shërbimeve cilësore në ndërmarrje hoteliere	10
3.Konceptet për cilësinë (TQM).....	13
3.1.Menaxhimi i cilësisë së produkteve	15
3.2.Cilësia në industrinë e shërbimeve	17
4.Ndikimi i faktorëve të mjedisit në ndërmarrje hoteliere	19
4.1.Avantazhet konkurrues në biznese	20
4.1.1.Faktorët e mjedisit furnizues të ndërmarrjes	22
5.Marketingu i shërbimeve në ndërmarrje hoteliere	24
Kapitulli III.....	
6.Rëndësia e industrisë së mikpritjes	25
6.1.Funksionet e ndërmarrjeve hoteliere dhe klasifikimi i tyre	27

6.2.Struktura organizative	29
Kapitulli IV	
7.Menaxhimi i ndermarrjeve hoteliere	31
7.1.Planifikimi në një ndermarrje hoteliere	32
7.2Drejtimi i një biznesi hotelier	34
Kapitulli V- Pjesa përmbyllëse	
8.Konkluzione dhe rekomandime.....	35
8.1.Literatura	37

KAPITULLI I PARË

1.Hyrje

Gjatë këtij punimi jam munduar të tregoj rëndësinë që ka menaxhimi i cilësisë në industrinë e hotelerisë duke përfshirë mikpritjen, akomodimin dhe rehatinë që ofrojnë për klientelën e tyre, si dhe krijimin e cilësisë më të lartë të menaxhimit. Thelbi i menaxhimit të cilësisë mund të përkufizohet si një aktivitet i qëllimshëm i menaxherëve dhe punonjësve të një ndërmarrje për të ndikuar në procesin e prodhimit në mënyrë që të përmirësohet vazhdimisht cilësia e produktit. Ky aktivitet mund të kryhet si nga drejtuesit e lartë ashtu edhe nga punonjësit e thjeshtë. Menaxhimi i cilësisë është një element i strukturës së përgjithshme të menaxhimit përgjegjës për zhvillimin e cilësisë, përcaktimin e qëllimeve, si dhe përcaktimin e detyrave përmes të cilave do të arrihen ato. Sigurisht që ka procese të tilla si planifikimi, si dhe sigurimi i të gjitha kushteve të nevojshme dhe furnizimi i burimeve për të siguruar që produktet të përmbushin standardet e vendosura. Vetë procesi i menaxhimit të cilësisë nënkupton kryerjen e vazhdueshme të një sërë funksionesh: planifikimin, organizimin, koordinimin, motivimin dhe kontrollin që janë esenciale që një ndërmarrje të arrijë të ofrojë shërbime dhe produkte cilësore.

1.1.Qëllimi i hulumtimit

Qëllimi i këtij hulumtimi është mbledhja e informacioneve të ndryshme të cilat mund të jenë shpjeguese dhe përshkruese të cilat tregojnë, se supozimet kanë qenë të shkruara dhe ne duhet të shpjegojmë, ndersa ato përshkruese njihen saktë dhe përshkruhen në mënyrë objektive. Hulumtimi i një natyre shkencore ka një drejtim sistematik dhe të synuar. Në këtë drejtim, është e rëndësishme të përcaktohet fusha e studimit. Çdo punë në njohuri shkencore fillon me krijimin e sistemit pas kalimit të kësaj faze, tema është formuluar. Qëllimi i studimit është rezultati përfundimtar i cili duhet të jetë rezultat i gjithë punës së planifikuar.

1.2.Kontributi shkencor-praktik i hulumtimit

Paraqet se si duhet të bëhet hulumtimi duke dhënë një vlerësim preliminar duke treguar se cilat do të jenë rezultatet e hulumtimit dhe pse janë të rëndësishme, si duhet ti përdorim, dhe a paraqesin vlerë të shtuar dhe kontribut në hulumtimin tonë, dhe si do të bëhet shpërndarja e atyre rezultateve.

1.3.Metodologjia e hulumtimit

Në këtë hulumtim kemi të bëjmë me mjetet që kemi përdorur për përfundimin e këtij punimi, duke bërë studimin e metodave të ndryshme dhe mënyren e fitimit të njohurive materiale, thelbi është që të kuptohen njohuritë shkencore dhe të vëndosen parime themlore në përvetsimin dhe shqyrtimin kritik të materialeve.

1.4.Rëndësia e punimit

Rëndësia e këtij punimi është të tregoj rëndësinë që ka menaxhimi i cilësisë në një ndërmarrje në këtë rast në ndërmarrje hoteliere duke përfshirë shërbimet dhe produktet që ofrojnë secila ndërmarrje. Rëndësi tjetër ka qenë të tregojë dhe të analizojë faktorët që ndikojnë në një biznes. Një qëllim tjetër ka qenë edhe rëndësia që ka marketingu në shërbimet hoteliere. Qëllim tjetër është rëndësia e cilësisë në industrinë e shërbimeve. Si dhe rëndësia e mikpritjes në ndërmarrjet hoteliere dhe ofrimi sa më cilësor i produkteve dhe shërbimeve për klientët e tyre.

Kapitulli i dytë

2.Funksioni i menaxhimit të cilësisë

Funksioni i Menaxhimit të Cilësisë ka rregulla dhe besime komplekse dhe themelore të përdorura për të menaxhuar dhe drejtuar një organizatë. Kështu, synohet të përmirësojë vazhdimisht performancën në lidhje me nevojat e klientëve dhe partnerëve të tjerë të biznesit në planin afatgjatë. Kushti që një organizatë të mbetet e suksesshme bëhet e mundur duke identifikuar vazhdimisht nevojat e palëve të interesuara dhe duke përmirësuar performancën e saj.¹ Menaxhimi i cilësisë janë të gjitha proceset që kryhen në një kompani ku të gjitha këto procese dhe metoda janë grupuar në një strukturë të vetme të quajtur sistemi i menaxhimit të cilësisë, i cili do të ndryshojë në varësi të llojit të organizatës, zonës në të cilën është dedikuar dhe objektivave të saj. Kur menaxhimi i cilësisë plotëson standarde të caktuara, ai mund të njihet me Standardi ISO, e cila vërteton se proceset e zbatuara në mënyrë sistematike nga organizata janë përkthyer në produkte dhe shërbime me parametrat më të lartë të sigurisë industriale, shëndetit dhe proceseve të prodhimit. Sistemi i menaxhimit të cilësisë është një lloj udhëzuesi që detajon proceset, procedurat, strukturën, burimet financiare, teknike dhe njerëzore që ka organizata.² Menaxhimi i cilësisë është akti i mbikëqyrjes së të gjitha aktiviteteve dhe detyrave që duhet të kryhen për të ruajtur një nivel të dëshiruar të përsosmërisë. Kjo përfshin përcaktimin e një politike të cilësisë, krijimin dhe zbatimin e planifikimit dhe sigurimit të cilësisë, si dhe kontrollin e cilësisë dhe përmirësimin e cilësisë. Gjithashtu quhet menaxhimi i cilësisë totale (TQM) mbështet idenë se suksesi afatgjatë i një kompanie vjen nga kënaqësia dhe besnikëria e klientit. TQM kërkon që të gjithë palët e interesuara në një biznes të punojnë së bashku për të përmirësuar proceset, produktet, shërbimet dhe kulturën e vetë kompanisë.³

Funksioni i cilësisë ka dy qëllime:

-zhvillimin, zgjerimin e produktit me cilësi apo shërbim të produktit bazuar në nevojat e konsumatorëve dhe kërkesat,

-ngritjen e cilësisë në të gjitha aktivitetet dhe funksionet e organizatës.⁴

¹ <https://www.sertifikasyon.net/sq/detay/iso-9001-kalite-yonetim-sistemi-temel-prensipleri-nelerdir/>

² <https://sq.warbletoncouncil.org/gestion-de-calidad-2007>

³ <https://www.investopedia.com/terms/q/quality-management.asp#:~:text=Quality%20management%20includes%20the%20determination,culture%20of%20the%20company%20itself.>

⁴ Menaxhimi i ushqimeve dhe pijeve Dr.sc.AdemDreshaj Peje 2017

2.1.Mjetet e planifikimit të cilësise

Menaxhimi i planifikimit të cilësisë ka të bëjë me kënaqësinë e klientit. Objektivi kryesor në menaxhimin e cilësisë është të sigurohet që plotëson nevojat që u krijua fillimisht për të përmbushur asgjë më shumë, asgjë më pak. Me fjalë të tjera, për sigurimin e cilësisë duhet të plotësoni nevojat e palëve të interesuara. Menaxhimi i cilësisë së përbëhet nga tre procese kryesore:

1. Plani i menaxhimit të cilësisë: identifikimi i kërkesave dhe standardeve të cilësisë për projektin dhe produktin (grupi i procesit të planifikimit).
2. Sigurimi i cilësisë ofron dëshmi për palët e interesuara se të gjitha aktivitetet e lidhura me cilësinë po kryhen siç janë përcaktuar dhe premtuar (grupi i procesit ekzekutues).
3. Kontrolli i cilësisë: Kontrolli i cilësisë përfshin teknika operationale që synojnë të garantojnë standardet e cilësisë si identifikimin, analizimin dhe korrigjimin e problemeve (grupi i procesit të monitorimit dhe kontrollit).⁵

Për zhvillimin e planifikimit të cilësisë duhet bazuar në një analizë të shërbimit në lidhje me -Shkallën në të cilën klienti i konsideron të rëndësishme secilen nga karakteristikat e shërbimit -Vlerësimin që bën secili prej tyre dhe -Vlerësimin e konkurrencës, kjo vlen për organizatat private të cilat do të marrin parasysh mendimet dhe vlerësimet që u bëhet konkurrentëve në bazë të kërkesave të konsumatorëve.

Kemi edhe organizata që ofrojnë shërbime të cilat kanë të bëjnë me: Cilësinë e kërkuar, me kërkesat e konsumatorëve, -Rëndësinë e konsumatorëve, Vlerësimin nga konkurrentët, -Cilësinë e planifikuar që është niveli në të cilën kompania do të jetë në të ardhmen, -Vlerësimin e organizatës që është, që ata japin për çdo aspekt të organizatës dhe shërbimet.⁶ Plani i menaxhimit të cilësisë është një pjesë kyçe e shërbimeve, pasi përshkruan se si standardet, udhëzimet, politikat dhe procedurat dhe sistemet organizative zbatohen për të përmbushur objektivat e cilësisë të shërbimeve, plani i menaxhimit në përgjithësi përfshinë standardet përkatëse të cilësisë, objektivat e cilësisë, rolet dhe përgjegjësitë e cilësisë, kontrollin e cilësisë së aktiviteteve, mjetet e cilësisë të zbatuara dhe çdo procedurë tjetër kryesore.⁷

⁵ <https://business.adobe.com/blog/basics/quality-management>

⁶ Menaxhimi i ushqimeve dhe pijeve Dr.sc.Adem Dreshaj Peje 2017

⁷ <https://jcu.pressbooks.pub/pmriskquality/chapter/module-7-quality-planning-tools-and-techniques/>

2.2. Procesi i ofrimit të shërbimeve cilësore në ndermarrje hoteliere

Procesi i ofrimit të shërbimeve do të thotë cdo aktivitet i cili është i aftë të ndjekë arritjen nëpërmjet veprimeve të koordinuara përballë kërkesave fillestare, ky proces duhet të ndërtohet mbi bazën e nevojave të konsumatorit por mbi të gjitha duhet të ketë parasysh strukturën shpërndarëse të shërbimeve. Duhet pasur parasysh se çfarë shërbimi është ofruar e rëndësishme është të përputhet me atë që konsumatori kërkon, pra kur kompania është në gjendje të ofrojë një shërbim që i plotëson kërkesat dhe nevojat e klientit atëhere shtohet efikasiteti dhe efektiviteti maksimal dhe minimizohet rreziku i dështimit. Qasja Total Quality kërkon një përkufizim të objektivave që të arrijnë mjetet e nevojshme për arritjen e tyre, identifikimin e të gjitha atyre aktivitete të cilat ndikojnë në cilësinë e shërbimit të ofruar dhe futjen e kontrollit, ku me këtë qasje është e mundur për ruajtjen e standardeve të cilësisë por edhe përmisimin e tyre, burimet njerzore janë elementi kyç në sigurimin e suksesit të kompanisë ku faktori njeri, luan një rol vendimtar dhe se trajnimi dhe shkollimi paraqet një element thelbësor për suksesin e procesit e sidomos në fushën e shërbimeve.⁸

Ndërmarrjet e hotelerisë janë pjesë përbërëse e sektorit të shërbimeve. Ofrimi i këtyre shërbimeve ka një efekt pozitiv në aktivitetet financiare dhe ekonomike dhe luan një rol të madh në rritjen e efikasitetit të prodhimit shoqëror. Procesi i prodhimit dhe konsumit zhvillohet në të njëjtin interval kohor. Për të marrë një shërbim hotelerie, është e nevojshme përfshirja e konsumatorit dhe e kontraktorit në procesin e konsumit. Për të ofruar një shërbim, stafi i hotelit duhet të kontaktojë drejtpërdrejt me konsumatorin, për klientin, ky kontakt është pjesë përbërëse e vetë shërbimit. Për të vlerësuar një shërbim, së pari duhet të konsumohet, një shërbim është një premtim për të kryer veprime specifike për të përmbushur nevojat e një klienti. Shërbimet e hotelit nuk mund të përgatiten paraprakisht pasi ato nuk janë të prekshme. Produkti i hotelit prodhohet në mënyrë që të plotësojë nevojat reale të klientëve, dhe ata duhet të kënaqen brenda një periudhe të caktuar kohore. Cilësia e shërbimeve të ofruara varet nga përformuesi i tyre dhe nga mjedisi për zbatimin e tyre. Aftësitë, disponimi dhe faktorë të tjerë mund të shkaktojnë ndikim të madh mbi cilësinë e performancës së shërbimit. Në të vërtetë, një dhe i njëjti interpretues mund t'i shërbejë një klienti në mënyra krejtësisht të ndryshme. Paqëndrueshmëria e shërbimit shpesh provokon në paknaqësitë e konsumatorëve.⁹

⁸ Menaxhimi i ushqimeve dhe pijeve Dr.sc.Adem Dreshaj Peje 2017

⁹ <https://shimanovskadm.ru/sq/priroda/platnye-i-besplatnye-uslugi-v-otele-i-opcii-nomerov-vidy-gostinichnyh.html>

3.Konceptet për cilësinë (TQM)

Menaxhimi i përgjithshëm i cilësisë (TQM) është një qasje që kërkon të përmirësojë cilësinë dhe performancën, e cila do të përmbushë ose tejkalojë pritjet e konsumatorëve. Kjo mund të arrihet duke integruar të gjitha funksionet dhe proceset e lidhura me cilësinë në të gjithë kompaninë. TQM shikon masat e përgjithshme të cilësisë të përdorura nga një kompani, duke përfshirë menaxhimin dhe zhvillimin dhe mirëmbajtjen e cilësisë, përmirësimin e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë. TQM merr parasysh të gjitha masat e cilësisë të marra në të gjitha nivelet dhe përfshinë të gjithë punonjësit e kompanisë.

Origjina e TQM

Menaxhimi total i cilësisë ka evoluar nga metodat e sigurimit të cilësisë të cilat u zhvilluan së pari gjatë kohës së Luftës së Parë Botërore. Përpjekjet e luftës çuan në përpjekje të prodhimit në shkallë të gjerë që shpesh prodhonin cilësi të dobët. Për të ndihmuar në korrigjimin e kësaj, inspektorët e cilësisë u futën në linjën e prodhimit për të siguruar që niveli i dështimeve për shkak të cilësisë, të minimizohej. Pas Luftës së Parë Botërore, kontrollet e cilësisë u bë më i zakonshëm në mjediset e prodhimit dhe kjo çoi në futjen e Kontrollit Statistikor të Cilësisë (SQC), një teori e zhvilluar nga Dr.W. Edwards Deming. Kjo metodë e cilësisë siguroi një metodë statistikore të cilësisë bazuar në marrjen e mostrave. Kur nuk ishte e mundur të kontrollohej çdo artikull, një mostër u testua për cilësinë. Teoria e SQC u bazua në nocionin se një ndryshim në procesin e prodhimit çon në ndryshim në produktin përfundimtar.¹⁰ SQC ruhet në TQM në elementin e katërt "kontrolli i cilësisë së prodhimit". Mund të pasqyrohet gjithashtu në elementin e tretë, "kontrolli i materialit të blerë". Me pak fjalë, kjo metodë thelbësore kërkon që standardet e cilësisë së pari të përcaktohen duke vendosur matje për një artikull të caktuar dhe duke përcaktuar kështu se çfarë përbën cilësi. Matjet mund të jenë dimensionale, përbërja kimike, reflektim, etj. Kontrolli i cilësisë më pas fillon gjatë procesit të prodhimit. Mostrat merren vazhdimisht dhe maten menjëherë, matjet regjistrohen në grafik, nëse matjet tregojnë një tendencë të padëshirueshme procesi ndalet dhe prodhimi ndërpritet derisa të gjenden dhe korrigjohen shkaqet. Kështu, SQC, ndryshe nga TQM, bazohet në matjen e vazhdueshme kundrejt një veprimi korrigjues standard dhe të menjëhershëm nëse matjet devijojnë nga një interval i pranueshëm.¹¹

¹⁰ <https://sq.unitinal.com/menaxhimi-i-cilesise-gjithsej-tqm-dhe-permiresimi-i-cilesise/>

¹¹ <https://www.inc.com/encyclopedia/total-quality-management-tqm.html>

Konsulentët dhe shkollat e ndryshme të mendimit theksojnë aspekte të ndryshme të TQM siç është zhvilluar me kalimin e kohës. Këto aspekte mund të jenë teknike, operacionale ose sociale/menaxheriale. Elementet bazë të TQM, për Kontrollin e Cilësisë, janë: 1) politika, planifikimi dhe administrimi; 2) dizajni i produktit dhe kontrolli i ndryshimit të dizajnit; 3) kontrolli i materialit të blerë; 4) kontrollin e cilësisë së prodhimit; 5) kontakti i përdoruesit dhe performanca në terren; 6) veprime korrigjuese; 7) përzgjedhja, trajnimi dhe motivimi i punonjësve.¹²

PARIMET E TQM

1 - Fokusi ndaj klientit- Çdo organizatë përpiqet t'i shërbejë vetëm një qëllimi, kënaqësisë së klientit përmes produkteve dhe shërbimeve cilësore. Do të thotë se produkti përfundimtar duhet të plotësojë kërkesat dhe nevojat e klientëve.

2 - Përfshirja e punonjësve- Kur zbatojnë TQM, organizatat duhet të krijojnë një mjedis ku punonjësit e tyre do të ndihen të fuqizuar. Ata, së bashku me menaxhmentin, bëhen përgjegjës për vlerësimin e cilësisë së produkteve dhe shërbimeve në nivelet e tyre.

3 - Sistemi i Integruar- Pasja e një sistemi të integruar është një domosdoshmëri për një organizatë për të zbatuar një strategji TQM në proceset e saj të biznesit. Prandaj, përfshirja e standardeve të cilësisë si standardet ISO 9000 mund të ndihmojë në prodhimin e produkteve dhe shërbimeve cilësore.

4 - Qasja në qendër të procesit- Një produkt ose shërbim arrin në treg pasi ka kaluar nëpër procese të ndryshme. Do të thotë se monitorohet dhe vlerësohet në çdo nivel prodhimi dhe jo vetëm në fazën përfundimtare.

5 - Rrjedha sistematike- TQM ka të bëjë me planifikimin strategjik për të arritur përsosmërinë e cilësisë dhe objektivat e biznesit. Marrja në konsideratë e një fluksi sistematik do të siguronte që produktet dhe shërbimet të kalojnë në çdo fazë të procesit të prodhimit cilësor.

¹² <https://www.inc.com/encyclopedia/total-quality-management-tqm.html>

6 - Përpjekje të vazhdueshme- Përmirësimi i cilësisë duhet të jetë një proces i vazhdueshëm. Që qasja TQM të rezultojë efektive, njerëzit në çdo nivel duhet të jenë vigjilentë për të qenë të rregullt me kontrollin e cilësisë.

7 - Vendimmarrja faktike- Organizata duhet të marrë vendime të bazuara në fakte sepse çdo punonjës merr pjesë në proceset e vlerësimit të cilësisë, duke përdorur të dhëna të performancës, si shitjet, fitimi dhe mbajtja e klientëve mund të rezultojë në një vendimarrje më të saktë.

8 - Menaxhimi i Marrëdhënieve- Një marrëdhënie e mirëmbajtur me palët e interesuara si klientët dhe punonjësit do të sigurojë procedura të duhura të kontrollit të cilësisë dhe reagime të sinqerta. Me TQM, organizatat mund të krijojnë komunikim efektiv me të gjithë ata dhe të zbatojnë ndryshime të orientuara drejt rezultateve.¹³

¹³ <https://www.wallstreetmojo.com/total-quality-management/>

3.1.Menaxhimi i cilësisë së produktëve

Menaxhimi i cilësisë së produktit është një grup gjithëpërfshirës i mjeteve që u mundëson organizatave të kontrollojnë dhe menaxhojnë të dhënat në lidhje me cilësinë e produktit në ndërmarrje. Këto të dhëna produkti përfshijnë defekte të produktit dhe prodhimit, dështimet në terren, ankesat e klientëve, përmirësimet e produktit dhe kërkesat për veprime korrigjuese dhe parandaluese. Menaxhimi i cilësisë përfshin katër komponentë kryesorë:

Planifikimi i cilësisë- Përpjekje të vazhdueshme për të gjurmuar defektet dhe për të përcaktuar shkaqet pas tyre.

Kontrolli i cilësisë- Reduktimi i kostove të prodhimit, riparimit dhe garancisë përmes gjurmimit dhe riparimit të defekteve.

Sigurimi i cilësisë- Ndjekja efektive e raporteve të problemeve dhe ankesave të klientëve në një përpjekje për të zgjidhur pyetjet në kohën e duhur.

Përmirësimi i cilësisë- Ndërveprimi me sistemet e tjera të menaxhimit të marrëdhënieve me klientët e ndërmarrjeve dhe integrimi me ndërmarrjet e tjera për importimin e ankesave të klientëve, informacione lidhur me cilësinë dhe problemet e prodhimit. Kjo përshpejton procesin e gjurmimit të cilësisë dhe siguron një depo qendrore për gjurmimin e të dhënave që lidhen me cilësinë e produktit.

Shumë furnizues produktesh e njohin cilësinë si një faktor kryesor që mund t'i veçojë produktet e tyre nga ato të konkurrentëve të tyre. Shumë kompani prodhuese tani ndjekin serinë e standardeve ISO 9000, të cilat përdoren nga kompanitë në mbarë botën për menaxhimin e cilësisë së produktit.¹⁴ Disa nga aspektet thelbësore të menaxhimit të produktit janë zgjedhja e mallrave dhe shërbimeve që do të komercializohen, duke marrë parasysh fuqinë e tyre në treg dhe praninë në një sektor të caktuar, kërkime dhe njohuri për tregjet. Kompanitë kërkojnë mundësi ku mund të kenë një shkallë më të madhe konkurrueshmërie, si në krijimin e produkteve të reja ashtu edhe në të gjitha fazat, nga prodhimi deri te shpërndarja, shitja përfundimtare dhe shërbimet pasuese për klientët. Menaxhimi i mirë i produktit duhet të shërbejë për të forcuar markën dhe për t'i dhënë kompanisë përfitime ekonomike, konkurruese dhe reputacionale.¹⁵

¹⁴ <https://www.techopedia.com/definition/26065/product-quality-management-pqm#:~:text=Product%20quality%20management%20is%20a,to%20product%20quality%20across%20enterprises.>

¹⁵ <https://www.definebusinessterms.com/sq/menaxhimi-i-produktit/>

Cilësia e produktit fiton besnikërinë e klientit, ndihmon në krijimin e njohjes së markës dhe menaxhon kostot. Konsumatorët shpesh blejnë më shumë nga kompanitë që njohin dhe besojnë, dhe bizneset mund të ulin kostot që vijnë nga kthimet, defektet dhe humbjet e produktit përmes kontrollit të cilësisë së produktit. Duke siguruar cilësinë e produktit, ju mund t'i ndihmoni klientët të njohin markën tuaj, t'i inkurajoni ata të blejnë produktet tuaja dhe të rrisin të ardhurat tuaja. Cilësia e produktit i referohet asaj se sa mirë një produkt i plotëson nevojat e klientit, i shërben qëllimit të tij dhe i plotëson standardet e industrisë. Kur vlerësojnë cilësinë e produktit, bizneset marrin parasysh disa faktorë duke përfshirë nëse një produkt zgjidh një problem, funksionon në mënyrë efikase dhe i përshtatet qëllimeve të klientëve. Perspektivat që duhen marrë parasysh gjatë vlerësimit të cilësisë së produktit përfshijnë perspektivat e klientit, perspektivat e prodhimit, perspektivat e bazuara në produkt, vlerat dhe perspektivat transcendentale, të cilat perceptojnë vlerën e një produkti në lidhje me koston e tij. Duke përdorur këto këndvështrime, mund të përcaktojmë cilësinë e produktit sipas:

Performancës dhe funksionit e synuar,

Besueshmëria e produktit brenda një afati kohor të caktuar,

Pajtueshmëria me specifikimet e produktit,

Qëndrueshmëria dhe jetëgjatësia e produktit

Shërbimi i produktit

Karakteristikat fizike të produktit

Perceptimi i klientëve për produktin

Menaxhimi i cilësisë së produktit, ose shkurt PQM, është një metodë që i ndihmon bizneset të identifikojnë defektet e produktit dhe të regjistrojnë shqetësimet e klientëve. Menaxherët e produktit aplikojnë më pas informacionin që regjistrojnë për të zbutur problemet dhe për të bërë përmirësime në të ardhmen në cilësinë e produktit. PQM mbulon katër fusha të dallueshme të vlerësimit të cilësisë së produktit, duke bërë përfshirjen e planifikimit, kontrollit, sigurimin e cilësisë dhe përmirësimin.¹⁶

¹⁶ <https://www.indeed.com/career-advice/career-development/product-quality>

3.2.Cilësia në industrinë e shërbimeve

Elementi kryesor i një produkti është individi, dhe se në industrinë e shërbimit procesi i prodhimit përfshin një ndërthurje midis konsumatorëve dhe stafit me mënyrat e të sjellurit dhe të vepruarit që marrin pjesë në procesin e prodhimit, shpesh ndodh që konsumatorët duan që produkti të jetë pjesë e ndjenjave dhe dëshirave të tyre. Cilësia e shërbimit është një faktor dominant që ndikon dhe përcakton prodhimin afatgjatë të ndërmarrjeve të shërbimit, dhe shihet si pika fillestare dhe përfundimtare e përpjekjeve për të arritur kenaqësinë e konsumatorëve. Cilësia e shërbimeve përcaktohet nga dy prespektivave:

-Nga ana e ndërmarrjes e cila lidhet me teresinë e faktorëve materiale dhe jomateriale, me cilesinë e personelit, teknikat e komunikimit me klientin, cilësinë e paisjeve, me organizmin e brendshëm dhe strategjitë.

-Nga pikëpamja e klientit ku cilësia është subjektive sepse lidhet me kënaqësinë e preceptuar nga klienti dhe bazohet në gjykimin e tij.

Pra cilësia finale e një produkti ose shërbimi rezulton nga kombinimi i disa faktorëve cilësor nga cilësia e njerzëve, metodave, mjetet e përdorurasi dhe cilësia e ambientit. Aktiviteti i çdo ndërmarrje shërbimesh mund të shikohet si një përmbledhje e proceseve larg syve të klientëve dhe proceseve që zhvillohen në kontakt me klientin. Politikat, veprimet, kontrolli për cilësinë bazohen mbi një vlerësim të fazave dhe elementeve që shoqërojnë proceset e prodhimit, shërbimit të klientëve dhe organizmit të ndërmarrjes.¹⁷ Shërbimi është pjesa kryesore e mbajtjes së përdoruesve të angazhuar me një organizatë. Cilësia e shërbimit është një masë se si një organizatë i kupton nevojat e përdoruesve të saj dhe i përmbush pritshmëritë e tyre. Të kuptuarit se si të përmirësoni cilësinë e shërbimit të produktit tuaj është hapi kryesor drejt rritjes për çdo organizatë. Matja dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimit është një art i vlefshëm por që ka kërkime dhe ekspertizë. Për të mësuar më shumë rreth cilësisë së shërbimit, ne duhet të kuptojmë dimensionet kryesore të cilësisë së shërbimit. Dimensionet kryesore mund të kategorizohen në 5 komponentë.

¹⁷ Produkti Turistik Klodiana Gorica, Nevila Kocollari Tirane Janar 2002

1. Besueshmëria e cilësisë së shërbimit-Konsistenca gjatë gjithë vitit jo vetëm që do të sigurojë probabilitetin që një produkt ose shërbim të funksionojë sipas dëshirës, por gjithashtu të sigurojë që të mos ketë thyerje në dërgesat siç përcaktohet. Kjo ndihmon në zbulimin e masave të përvojës së klientit, si dhe rreziqeve të mundshme në humbjen e klientëve nga konkurrenca. Mund të ketë shumë faktorë që mund të shkaktojnë ndërprerje ose prishje të cilësisë së një shërbimi që ofrohet, veçanërisht në rastin e ndërmarrjeve që ofrojnë shërbime të vazhdueshme.

2. Prekshmëria e Cilësisë së Shërbimit-Konsumatorët duhet të ndiejnë një ndjenjë të prekshme të cilësisë në nivelin e shërbimeve që u ofrohen. Cilësia totale e perceptuar bazohet në krahasimin e cilësisë së pritur me cilësinë e përvojës. Lloje të shumta kërkimesh kanë treguar se cilësia me përvojë mund të matet me: Cilësia teknike – Qfare, Cilësia funksionale - Mënyrat

3. Përgjegjshmëria-Të qenit të përgjegjshëm ndaj konsumatorëve tuaj, t'i bëni ata të ndihen të dëgjuar dhe t'u jepni atyre drejtimet e duhura është një faktor kyç në cilësinë e shërbimit. Të kuptuarit e klientit tuaj, ofrimi i përvojës së vazhdueshme mbështetëse, ofrimi i udhëzuesve për vetëndihmë, trajnimi i punonjësve, vendosja e objektivave të performancës për punonjësit tuaj dhe monitorimi i tyre janë disa nga faktorët kryesorë që do të përfitojnë organizimin dhe produktin.

4. Sigurimi i cilësisë së shërbimit- Siguria mat aftësinë e ofruesve të shërbimeve për të transmetuar besimin tek klientët, gjë që është thelbësore në marrjen e besimit të klientët që të qëndrojnë me organizatën në krahasim me konkurrencën. Siguria mund të shënohet në mënyra të ndryshme, besnikëria ndaj markës mund të jetë e para. Njerëzit në përgjithësi priren t'i besojnë një marke me të cilën janë njohur.

5. Empatia-Të kuptuarit e rastit të përdorimit të konsumatorit, se si produkti do të jetë i dobishëm për ta, duke i udhëhequr dhe ndihmuar ata të arrijnë qëllimet e tyre dhe të qenit empatik ndaj nevojave të tyre është një proces shumë i rëndësishëm për një organizatë. Empatizimi me klientët do t'i bënte ata të ndihen të vlerësuar dhe kjo do ta bëjë përdoruesin të jetë besnik ndaj produktit dhe shërbimeve tuaja.¹⁸

¹⁸ <https://www.questionpro.com/blog/service-quality/#:~:text=Service%20quality%20is%20a%20measure,quality%20is%20a%20valuable%20art.>

4.Ndikimi i faktorëve të mjedisit në ndërmarrje hoteliere

Faktorët veprues të ndërmarrjes vazhdimisht përballen me mjedisin me të cilin ajo vepron, ku këta faktorë imponojnë kërkesat e saj në cilësinë e produktit dhe në njohjen e cilësisë. Kemi mjedisin e përgjithshëm (kontekstual), dhe mjedisin e menjëhershëm (oprativ), që ndikojnë në veprimtarinë e bizneseve në mënyra të ndryshme si në procesin e transformimit por edhe në procesin e blerjes së burimeve dhe në krijimin dhe në konsumin e prodhimit. Në mjedisin e menjëhershëm përfshihen furnizuesit, konkurrentët, tregu, konsumatorët, ndërsa në mjedisin e përgjithshëm përfshihen faktorët ekonomik, politik, kulturore, dhe ata teknologjik. Këta faktorë ndikojnë në një shumëllojshmëri të gjerë të ndërmarrjes.

Mjedisi i përgjithshëm (kontekstual)- përbëhet nga forcat sociale të cilat organizata nuk mund ti kontrollojë por vetëm mundohen të parashikojnë dhe t'u përgjigjen në mënyrë efektive të mundshme.

Mjedisi politik- mund të godas në aktivitetin e ndërmarrjes në shumë aspekte të cilat kanë të bëjnë me natyrën e sistemit politik, proceset dhe institucionet e saj si dhe deri në përfshirjen e qeverisë në punët ekonomike dhe përpjekjet e saj për të ndikuar në strukturën dhe sjelljen e tregut ku në mënyrë direkte dhe indirekte kanë ndikim të madh në aktivitetet e ndërmarrjes.

Mjedisi ekonomik- ka të bëjë me ceshtjen se mjedisi ligjor luan një rol të madh në ekonominë coftë në nivel nacional dhe në atë local dhe ndihmonë në harmonizimin e dy aktiviteteve kryesore kërkesen dhe ofertën.

Mjedisi kulturorë- ndikojnë në llojin e produkteve që duhet prodhuar apo shitur, tregjet në cilat janë shitur, çmimi më të cilin ato janë shitur dhe një varg tjetër i variablave. Njeriu është burim kyç organizativ dhe pjesë themelore e trgut për mallra dhe shërbime.

Mjedisi teknologjik- Teknologjia është faktori kryesor i çdo organizate biznesore sepse paraqitet si input dhe output i organizatave të biznesit, investimet në teknologji është pare si çelës për suksesin e një ndërmarrje, gjithashtu është përgjegjës për zhvillimi të rendësishëm në organizimin e brendshëm të ndërmarrjes.¹⁹

¹⁹ Mjedisi i biznesit Ian Worthington dhe Chris Britton. Djeto 2015

Mjedisi i menjëhershëm (operativ)- ka të bëjë me nevojat e organizatës për burime të ndryshme të cilat kanë lidhje direkte me rrjetin e produkteve që ofron organizata dhe si segmentimin e tregut.

Mjedisi furnizues- mardhënia midis një prodhuesi dhe furnitoreve të tij është e rëndësishme në lidhje me cilësinë përfundimtare të produktit tuistik, kjo qëndron nëse furnitorët ofrojnë produkte të rëndësishme për tregun aktual, ndërmarrjet mundohen të bashkpunojnë dhe qëndrojnë afër furnitorëve të tyre për të rritur cilësinë e produktit të tyre.

Mjedisi konkurrues- në mes një ndermarrje dhe konkurrentëve përkatës ekziston një mardhënie komplekse, duke influencuar njera-tjetren në nivelet e cmimit, në zhvillimin e produktit, në sistemin e shpërndarjes si dhe në teknikat promovionale. Ekzistenca e konkurrencës në tregun turistik përmison më shumë cilësinë e produkteve.²⁰

Mjedisi i tregut- duke identifikuar nevojat e tregut për një produkt konsiderojmë nevojat e konsumatorëve, ku nga pozita e organizimit dhe tregut klientët kanë shkëmbim të vazhdueshëm të informatave, mjeteve teknike të favorizuara nga komunikimi aktual. Për të krijuar kërkesën e saktë të tregut duhet të kuptojmë; karakteristikat e tregut dhe të shitjes, mundësitë e parashikimit dhe sistemet e informacionit, dhe të dhënat mbi produktet.

Mjedisi i konsumatorëve- ka të bëjë me faktorët e organizimit me të cilat vihet në dijeni të shfaqjes së nevojave, kërkesave dhe aftësive për ndarjen në treg. Komponentët thelbësorë të nevojës të cilat i jepin efektivitetin janë; dëshirat, shijet e klientit dhe preferencat për qështjen e produktit, konsumatori ka fuqi blerëse dhe ky është aspekti ekonomik i aplikimit dhe konsumatori duhet për të blerë që është aspekt i vullnetshëm i veprimit dhe vendimit.²¹

²⁰ Produkti turistik Klodiana gorica dhe Nevila Kocollari Tirane 2002

²¹ Menaxhimi i ushqimeve dhe pijeve Dr.sc.Adem Dreshaj Peje 2017

4.1. Avantazhet konkurruese në biznese

Avantazhi konkurrues është një avantazh që e lejon kompaninë të mbijetojë pavarësisht se bizneset konkurruese përpiqen të fitojnë para në të njëjtën mënyrë. Avantazhi konkurrues i referohet faktorëve që lejojnë një kompani të prodhojë mallra ose shërbime më mirë ose më lirë se rivalët e saj. Përparësitë konkurruese i atribuohen një sërë faktorësh duke përfshirë strukturën e kostos, markën, cilësinë e ofertave të produkteve, rrjetin e shpërndarjes, pronësinë intelektuale dhe shërbimin ndaj klientit. Avantazhi konkurrues është ajo që i bën produktet ose shërbimet e një njësie ekonomike më të dëshirueshme për klientët sesa ato të çdo rivali tjetër. Përparësitë konkurruese mund të ndahen në avantazhe krahasuese dhe avantazhe diferenciale.

Avantazhi krahasues është aftësia e një kompanie për të prodhuar diçka më efikase se një rival, gjë që çon në fitimin më të madh.

Avantazh diferencial është kur produktet e një kompanie shihen si unike dhe të cilësisë më të lartë, në krahasim me ato të një konkurrenti.

Avantazhi konkurrues gjeneron vlerë më të madhe për një firmë dhe aksionarët e saj për shkak të pikave të forta ose kushteve të caktuara. Sa më i qëndrueshëm të jetë avantazhi konkurrues, aq më e vështirë është për konkurrentët të neutralizojnë atë, për të ndërtuar një avantazh konkurrues, një kompani mund të përdorë një nga tre metodat kryesore: Kostoja; Ofroni oferta me çmimin më të ulët, Diferencimi; Ofroni oferta që janë superiore në cilësi, shërbim ose veçori, Specializimi; Ofroni oferta të përshtatura ngushtësisht për një treg të fokusuar. Konkurrenca në çmim mund të jetë efektive, por ulja shumë e çmimit, rrezikoni të zvogëloni fitimin në një nivel të paqëndrueshëm. Kur një kompani krijon një avantazh të qëndrueshëm konkurrues, ajo veçohet nga konkurrenca dhe u ofron vlerë klientëve, duke prodhuar një produkt ose shërbim të dëshirueshëm që është më i mirë ose më kosto-efektiv se konkurrentët e saj, kompania mund të bëjë më shumë shitje, të gjenerojë më shumë të ardhura dhe të gëzojë fitime më të mëdha. Për të krijuar një avantazh konkurrues, një kompani duhet të dijë se çfarë e dallon atë nga konkurrentët e saj dhe më pas të fokusojë mesazhin, shërbimin dhe produktet e saj.²²

²²https://www.investopedia.com/terms/c/competitive_advantage.asp#:~:text=Competitive%20advantage%20refers%20to%20factors,compare%20to%20its%20market%20rivals.

4.1.1. Faktorët e mjedisit furnizues të ndermarrjes

Menaxhimi i furnizimit ka hapur një rrugë efektive për dërgesat në kohë, performancën e përmirësuar financiare, kënaqësinë më të madhe të klientit, ndërtimin e besimit midis furnitorëve të cilat e përmirësojnë performancën e një ndermarrje në afat të gjatë. Por për aq sa një zinxhir furnizimi ndihmon në arritjen e një rezultati pozitiv për biznesin tonë, është e rëndësishme të punojmë mbi faktorët që mund të drejtojnë rezultatet e ndermarrjes në mënyra të tjera. Këta faktorë kanë tendencën të ndikojnë në çdo sistem efektiv të menaxhimit të furnizimit:

